

VENDIM
Nr. 705, datë 6.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT ‘EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA’, NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe të aktit normativ nr. 5, datë 18.10.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022, ‘Për buxhetin e vitit 2023’”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Financimin, në masën 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekë, të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të ndarë:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;
b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023.”.
b) Në pikën 2, pas fjalëve “... për vitin 2022 ...” shtohen “... dhe buxheti i miratuar për vitin 2023 ...”.

c) Në pikën 3, pas fjalëve “... brenda muajit janar 2023 ...” shtohen “... dhe brenda muajit shkurt 2024, përkatësisht për financimet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi ...”.

ç) Fjalja e dytë, e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Brenda muajit shkurt 2024 të depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raporti vjetor i veprimtarisë së projektit “Ekipet sportive në shkolla”, përfshirë raportimin financiar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku